

"ENGINEERING & LEGAL CONSULTING"

RELACION KONSTRUKTIV I GJIMNAZIT

➤ Gjimnazi "Sali Nivica"

Rikonstrukcioni i gjimnazit "Sali Nivica" eshte nje domosdoshmeri per Qytetin e Memaliajt, per vete rendesine arsimore te ketij institucioni. Kjo shkolle ka qene nder te parat institucione arsimore ne qytetin e Memaliajt.

Krijimi i ambienteve bashkohore, per nje arsimim sa me te mire te nxenesve eshte i domosdoshem dhe per permiresimin dhe persosjen e kushteve te punes se mesuesve, me qellim rritjen e cilesise se mesimdhencies ne shkolle me standarte bashkohore.



Gjendja Ekzistuese e gjimnazit "Sali Nivica"

KARAKTERISTIKAT E OBJEKTIT

➤ Gjimnazi "Sali Nivica"

Ndertesa ekzistuese e gjimnazit perbehet nga 3 objekte. Objekti i pare kryen funksionin e gjimnazit perbehet nga 3 kate me siperfaqe totale 1583 m², objekti i dyte qe kryen funksionin e palestres eshte 1 kat me siperfaqe totale 217 m², dhe objekti trete eshte dhome teknike per kaldajen 17 m².

Te tre objektet jane te lidhura me njera tjetren dhe sebashku me shkollen 9-vjecare jane te vendosur mbi nje truall me siperfaqe totale 26000 m². Gjimnazi frekuentohet gjithmone e me pak, per shkak te kushteve jo shume te mira, ambientet jane totalisht te amortizuara nga vjetersia dhe lageshtia. Gjimnazi ka mungese ambienteve funksionale per laboratore, salla informatike, ambiente sportive, ndenie, argetim, etj. Ne institucion mungojne kushtet minimale sipas kerkesave bashkekohore si ngrohja qendrore, ambientet per argetim dhe tualetet higjenike. Ndertesa ekzistuese eshte rreth 35-vjecare. Per kete arsye dhe per ta plotesuar me parametra

"ENGINEERING & LEGAL CONSULTING"

bashkohore eshte e domosdoshme rikonstruksioni total i gjimnazit. Siperfaqja e rikonstruksionit te objektit eshte 1800 m².

Objekti ekzistues eshte i amortizuar pamvarsisht investimeve te bera ne periudha te ndryshme te cilat kane qene pjesore. Qe nga koha e ndertimit tij i jane bere nderhyje te pjeseshme ne suvatime dhe lysterje me boje plastike. Taraca eshte me solete dhe cati e cila eshte amortizuar dhe ka lageshtire. Mungon hidroizolimi dhe termoizolimi. Suvatimi i brenshem eshte i amortizuar, dhe e nje cilesi te dobet. Pllakat e dyshemese jane majolike te amortizuara dhe nga ndertimi i sistemit te ngrohjes do te demtohen. Ngrohja ka dale jashte perdorimit dhe me heret ajo behej me kaldaje me nafte e cila eshte e amortizuara.. Tualetet (WC) jane te amortizuara totalisht standart i domosdoshem per tu afruar me direktivat e Bashkimit European. Oborri nga pas eshte me balte, dhe i pa organizuar. Mungon sistemi i furnizimit me uje, kanalizimit te ujrave te bardha dhe te zeza eshte i amortizuar.

Projektit i rikonstruksionit te gjimnazit eshte hartuar duke shfrytezuar te gjitha ambientet ekzistuese. Eshte bere e mundur te realizohen: mjediset e nevojshme, funksionale duke ndertuar dhoma me parametra optimal.

Ne katin perdhe jane parashikuar 4-klasa, 2-kabinet, 1-depo, 1-gjuhe e huaj,1-amb sanitare, 2-dhoma zhveshje dhe 2 tualete me nga tre WC per secilen gjini. Palestra ka hyrje me vete dhe eshte e lidhur me shkollen. Ne katin perdhe eshte ambienti teknik i kaldaje s e cila nuk eshte lidhur me shkollen.

Ne katin e pare jane parashikuar 2-kabinete, 3-klasa, drejtori, nendrejtori sekretasia dhe salla e mesuesve, 1-depo, 2 tualete me nga tre WC per secilen gjini.

Ne katin e dyte jane parashikuar 2-kabinete, 4-klasa, biblioteke, salla e mesuesve, 1-depo, 2 tualete me nga tre WC per secilen gjini.

Gjimnazi i rikonstruktuar do te kete nje hyrje kryesore. Ne gjimnaz eshte parashikuar ngrohja qendrore e cila eshte me kaldaje me djegje pelet. Ajo eshte vendosur ne dhomen teknike ekz. Gjithashtu jane parashikuar qe dritaret te jene dopio xham. Do te rikonstruktohet catia e gjimnazit.


Jane parashikuar te gjitha zerat e rifinitures duke bere suvatim me fino te gatshme nga brenda dhe suvatim grafiato nga jashte. Termoizolimi do te realizohet me polisterol me sistem kapot t=5cm nga te gjitha anet. Shtresat e dyshemese jane rere per nivelim 7cm, lluster cemento 2-3cm, pllake gres porcelanat me siperfaqe te ashper. Veshja e banjes do te jete me pllake majolike. Izolimi i banjes do te behet mbi shtresen e lluster cimentos me disa duar paste bituminoze dhe kk 4mm e cila do te ngjitet ne mure ne nje lartesi 30-40cm. Paisjet e tualeteve do te jene porcelani cilesi e I importi. Banjat do te kene uje te ngrohje me bolier te cilat do ti bejne ato ambiente funksionale. Shkallet do te vishen me mermer dhe plintuset do te jene prej mermeri.

"ENGINEERING & LEGAL CONSULTING"

Gjithashtu mermer ka ne dyert e jashteme. Davancialet e dritareve jane mermeri me zmuso dhe pikore nga te dy anet. Dyert e jashteme jane te blinduara gjithashtu edhe drejoria dhe salla e mesuesve. Dyert e brenshme jane prej druri pishe cilesi e pare. Dritaret jane me dyralumin termoplastik e cila ruan temperaturen e ambientit.

Do rikonstruktohen totalisht instalimet elektrike, ndricimi, rrjetin telefonik, interneti, furnizimin me uje, kanalizim i ujrave te ndotur dhe ngrohja qendrore. Ambientet e jashteme jane sistemuar me pllaka betoni dhe mbjellje me bar.

Ujerat sipërfaqesor jane sistemuar me kunete betoni te cilat mblidhen ne puseta shiu dhe derdhen ne kolektorin me te afert. Cilesia e materialeve qe eshte parshikuar te perdoren duhet te jete e larte sipas niveleve bashkekohore.



Gjendja e Propozuar e Gjimnazit

PER SA ME SIPER RIKONSTRUKSIONI I GJIMNAZIT NUK KA NDERHYRJE KONSTRUKTIVE .

Hartoi;

Ing.Blerim BRAJA